



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2020:021299

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05537725

P.nr.72/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit B.K, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.223/2020 të datës 18.02.2020, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë më datë **21.02.2024**, në praninë e Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit B.K dhe mbrojtësit të tij av.Osman Lajqi nga Peja, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 18.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B.K, i lindur me datë ... në fshatin S. ku edhe banon Komuna I., nga i ati G. dhe e ëma R. e gjinisë P., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, përfitues i asistencës sociale, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me numër..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me parë e gjerë me datë 26.01.2020, rreth orës 14:30, në fshatin S. Komuna I., i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par. 1 të Ligjit për Armë (Ligjit Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll dhe atë: një pushkë gjuetie prodhim turko-belg, 12 GA, me numër serik 162296, kal.12 mm, 2 (dy) copë fishek kal.12 mm, në atë mënyrë që ditën kritike gjersa Policia e Kosovës ishin duke patrulluar në vendin e lartcekur, aty kanë ndalur të pandehurin B.K, i cili me vete kishte armën me të dhënat e lartcekura pa leje dhe me pas të njëjtën armë policia e kanë konfiskuar.

- me këtë ka kryer veprën penale **mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 të KPRK-së dhe neneve 230, 364, 369 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i shqipton:

DËNIM MË GJOBË

- I.** Ashtu që, të pandehurit **B.K** i shqiptohet **dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro**, të cilën gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguan dënimin me gjobë në afatin kohor të përcaktuar me lartë, atëherë dënimi më gjobë do të zëvendësohet më dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ku për çdo njëzet (20) euro të gjobës, do ti llogariten me një (1) ditë burgim, *përkatësisht 15 ditë burgim.*
- II. KONFISKOHEN:** një pushkë gjuetie prodhim turko-belg, 12 GA, me numër serik 162296, kal.12 mm; 2 (dy) copë fishek kal.12 mm; Leja e armës në emër të Gani Kamberaj me numër WRC-04-25233 dhe Libreza e anëtarësisë në emër të Gani Kamberaj me numër 473/2003. Të cilat kanë qenë të specifikuar edhe sipas listës së Vërtetimit mbi sekuestrimin e sendeve, nga Stacioni Policor Kufitar Vitomicë, numri i rastit 2020-YWA-006 dt. 26.01.2020. **URDHËROHET** që të gjitha këto, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të shkatërrohen.
- III.** I pandehuri lirohet në tersi nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.
- IV.** Palë të dëmtuara nuk kishte.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.223/2020 të datës 18.02.2020, kundër të pandehurit B.K, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, të cilës aktakuzë i është bashkangjitur edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë me numër PP/II.nr.223/2020 e datës 13.02.2020, e arritur ndërmjet Kryeprokurorit dhe prokurorit të shtetit të kësaj prokurorie, në njëren anë dhe të pandehurit B.K dhe mbrojtësit të tij av. Osman Lajqi në anën tjetër.

Gjykata me datë 21.02.2024, ka caktuar dhe mbajtur seanca dëgjimore lidhur me shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Dorjan Juniku dhe i pandehuri B.K se bashku me mbrojtësin e tij av. Osman Lajqi i caktuar sipas

detyrës zyrtare, në të cilën seancë është shqyrtuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, me ç'rast pas dëgjimit të palëve, lidhur me marrëveshjen për pranim të fajësisë, është konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë sipas marrëveshjes, si dhe marrëveshja është bërë në baza vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, i pandehuri nuk ka qenë i shtrënguar apo i detyruar në lidhjen e marrëveshjes, pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat që i janë bashkëngjitur aktakuzës, si dhe nuk ekziston asnjëra nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale të përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPP-së, andaj gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe është e bazuar në nenin 230 par. 20 të KPP-së dhe si të tillë e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Gjykata pas pranimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, te njëjtën ditë ka vazhduar seancën për caktimin e dënimit, ku **prokurori i shtetit** ka deklaruar se sipas marrëveshjes së arritur janë dakorduar edhe për dënimin, ashtu që i ka propozuar gjykatës që dënimi për të pandehurin të jetë dënim me gjobë i precizuar në marrëveshje dhe te konfiskohen sendet e listuara në marrëveshje.

Mbrojtësi i të pandehurit B.K, av. Osman Lajqi, ka deklaruar se: mbetëm pranë propozimit për shqiptimin e dënimit sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe të gjitha arsyeve të lartcekura me lartë.

I pandehuri B.K ka deklaruar së pajtohet me deklarimet e mbrojtësit të tij dhe i premtion gjykatës se ne të ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do të kryej vepra penale.

Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri B.K ka kryer veprën penale te lartcekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe rrethanat personale se është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, premtimin se ne te ardhmen do te këtë sjellje të mira dhe se është mbajtës i familjes. Ndërsa **rrethana rënduese** gjykata nuk ka gjetur. Prandaj, në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 te KPRK-së.

Vendimi për konfiskim

Gjykata konform nenit 367 par.3 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konfiskuar sendet e specifikuara të lartcekura të përdorura nga i pandehuri në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 4 të KPP-së, e liroj të pandehurin nga shpenzimet e procedurës për faktin se i njëjti, është me gjendje te dobët ekonomike, përfitues i asistencës sociale, i pa punë dhe mbajtës i familjes, dhe se pagesa e këtyre shpenzimeve do të i'a rrezikonte gjendjen e tij materiale dhe të anëtareve te familjes te cilët detyrohet ti mbështes materialisht.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 230, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*